




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Kuvendi i Komunës – Deçan

Bazuar në nenin 12, paragrafi. 12.1 dhe 12.2 pika (c dhe d), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 15 pika 8 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5 dt. 31.10.2019, Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 07/2009 për vlerësimin e jashtëm dhe të mbrendshëm të shkollave, dhe Planit Zhvillimor të Arsimit në Deçan nr. Protokolli 01.nr.XII-7, dt.27.12.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur më datë 29.10.2021, e miratoj këtë:



RREGULLORE
PËR
VLERËSIMIN E SHKOLLËS MË TË MIRË NË KOMUNËN E DEÇANIT
- ÇMIMI 'NJAZI FERIZI'

Kapitulli I

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen të drejtat, detyrat, obligimet, përgjegjësitë si dhe menyra e vlerësimit të shkollës më të mirë në Komunën e Deçanit për çmimin “Njazi Ferizi”; ku do të vlersohën shkollat në bazë të fushave të performancës së shkollës si; 1. MENAXHIMI DHE QEVERISJA; 2. KULTURA DHE MJEDISI; 3. MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA; 4. ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE; dhe 5. PERFORMANCA E NXËNËSVE, për krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillim të procesit edukativo arsimor.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen në institucionet arsimore të Komunës së **Deçanit të Republikës së Kosovës**, gjatë vlerësimit të rezultateve të punës për të vlerësuar shkollën më të mirë në Komunën e Deçanit ku do të ndahet çmimi “Njazi Ferizi” në vlerë 10.000 euro nga Kuvendi - Komuna dhe Kryetari i Komunës së Deçanit.

Neni 3

Përkufizimet

Për qëllime të kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- 3.1 **Vlerësimi i rezultateve të punës**, nënkupton procesin e vlerësimit të realizimit të objektivave të punës për çdo shkollë të Komunës së Deçanit dhe vlerësimin e aftësive të personelit mësimdhënës, dhe menaxhmentit të shkollës që kanë shërbyer në arritjen e objektivave;
- 3.2. **I vlerësuar**, shkolla e cila i nënshtrohet vlerësimit të rezultatet të punës;
- 3.3. **Vlerësuesi**, komisioni i cili bën vlerësimin e rezultateve të punës së shkollës;
- 3.4. **Periudha e vlerësuar**, nënkupton periudhën për të cilën vlerësohen rezultatet e punës së shkollës dhe përfshin periudhën nga 1 shtatori deri më 31 gusht të vitit (shkollor) të vlerësuar.
- 3.5. **Periudha e vlerësimit**, nënkupton periudhën gjatë së cilës kryhet procedura e vlerësimit të rezultateve në punë dhe fillon nga 1 shtatori - 31 dhjetor të vitit (shkollor) të vlerësuar (kjo varet edhe nga Komisioni).
- 3.6 Komisioni vlerësues, për të vlerësuar shkollat, në shumë raste është i obliguar të vizitoj shkollat (kjo varet edhe nga Komisioni).
- 3.7 Termat e tjerë të përdorur në këtë Rregullore kanë kuptimin e njëjtë me termat e përdorur në Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjin nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Neni 4

Baza për vlerësimin e rezultateve të punës

Vlerësimi i rezultateve të punës bazohet në matjen e realizimit të objektivave dhe aftësive të shkollave për ngritje të cilësisë.

Neni 5

Vlerësimi në bazë të objektivave të punës

5.1 Objektivat janë prioritetet e punës së shkollës dhe përfshijnë aktivitetet që duhen realizuar deri në fund të periudhës së vlerësuar.

5.2 Vlerësimi i arritjes së objektivave nga shkolla bëhet në bazë të: planit individual vjetor të punës (i hartuar në pajtim me prioritetet e përcaktuara nga institucioni, përkatësisht nga njësia organizative ku bën pjesë shkolla) dhe përshkrimit të detyrave të punës.

Neni 6

Menaxhimi dhe udhëheqja

6.1. Aftësitë e shkollës përfshijnë aftësitë profesionale të personelit dhe shkathtësitë personale të treguara gjatë realizimit të detyrave dhe ushtrimit të përgjegjësisë në punë.

6.2. Siguron që vizioni, misioni dhe objektivat e shkollës t'i udhëheqin vendimet e menaxhmentit dhe organizimin e nxënies;

6.3 Vlerësimi i aftësive të menaxhmentit të shkollës bazohet në:

1.1. Aftësitë profesionale menaxheriale, që përfshijnë aftësitë për:

1.2. Planifikim dhe organizim;

1.3. Vendimmarrje;

1.4. Motivim (zhvillim) dhe trajtim të paanshëm të stafit.

6.4. Aftësitë dhe shkathtësitë personale, që përfshijnë:

1.1. Njohuritë profesionale/teknike;

1.2. Iniciativa dhe kreativiteti;

1.3. Puna në grup;

1.4. Aftësi komunikuese dhe përfaqësuese;

1.5. Efektiviteti në punë.

6.5. Planet vjetore të shkollës (për periudhën që mbulohet nga plani zhvillimor) dhe raportin e vetëvlerësimit të fundit të shkollës.

6.6. Dokumentet tjera shkollore, të cilat mund të shfrytëzohen si burime të të dhënave (varësisht nga fushat e cilësisë të cilat janë në fokus të vlerësimit), përfshijnë:

6.7. Procesverbalet dhe vendimet e mbledhjeve të ndryshme të mësimdhënësve (në kuadër të organeve profesionale të shkollës),

6.8. Procesverbalet dhe vendimet e mbledhjeve të ndryshme të organeve qeverisëse,

- 6.9. Dëshmitë e procesit të hartimit të PZhSh,
- 6.10. Dëshmitë e procesit të vetëvlerësimit të shkollës,
- 6.11. Planet e shkollës për zhvillim profesional,
- 6.12. Planet individuale zhvillimore të mësimitdhënësve,
- 6.12. Materialet dhe produktet e **ZhPM** (*portfolio, materiale mësimore, certifikata, procesverbale nga seanca reflektimi etj.*),
- 6.13. Mostrat e planeve mësimore (*planet për shkollë, planet vjetore, mujore, ditore*),
- 6.14. Kurrikula me bazë në shkollë, përfshirë kriteret në bazë të të cilave shkolla është përcaktuar për KBSH,
- 6.15. Mostrat e materialeve të përdorura nga shkolla. Raportet e shkollës mbi nivelin e përgjithshëm të performancës së nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore,
- 6.16. Raportet e shkollës mbi nivelin e përgjithshëm të arritshmërisë së nxënësve në rezultate të përcaktuara për fushat kurrikulare,
- 6.17. Mostrat e PIA-së të nxënësve,
- 6.18. Krijon dhe mban një mjedis shkollor të sigurt, të pastër dhe miqësor.

Neni 7

KULTURA DHE MJEDISI

7.1. Treguesit e performancës:

- 1.1. Objekti dhe hapësirat përcjellëse të shkollës janë të qasshme, të sigurta, të shëndetshme dhe miqësore.
- 1.2. Shkolla siguron për të gjithë nxënësit mundësi të barabarta për zotërimin e kompetencave.
- 1.3. Mjedisi dhe kultura e punës së shkollës janë në funksion të nxënies së integruar dhe jetësimit të kurrikulës.
- 1.4. Shkolla ka praktika të konsoliduara të përfshirjes së gjithë komunitetit shkollor në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit fizik.
- 1.5. Shkolla ofron një mjedis të sigurt dhe mundësues për realizim të të nxënësve efektiv.

Neni 8

MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA

Shkolla, siguron që të gjithë nxënësit të kenë qasje të vazhdueshme në mundësitë për mësimdhënie dhe nxënie cilësore përmes zhvillimit të një kulture shkollore e cila vlerëson dhe mbështetë mundësi të barabarta për nxënie të nxënësve dhe ngritje profesionale të personelit.

8.1 Treguesit e performancës:

Shkolla, për ta arritur këtë standard, kryen aktivitetet në vijim:

- 1.1 Mbështetë dhe mundëson ngritje të plotë profesionale për mësimitdhënësit, me një vëmendje të veçantë tek nxënia në përputhje me vizionin dhe objektivat e shkollës;

- 1.2. I identifikon, i qartëson, dhe i adreson sfidat në nxënie duke i përfshirë edhe ato çështje që bazohen në kontekstin gjinor;
- 1.3. Siguron që nxënësit me nevoja të veçanta të marrin pjesë në programe të përshtatshme;
- 1.4. Inkurajon dhe modelon nxënien gjatë gjithë jetës për nxënësit dhe personelin;
- 1.5. Përshtatë dhe zbaton programe kurrikulare, ndër-kurrikulare, dhe jashtëkurrikulare të cilat janë të disponueshme për të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë;
- 1.6. Zbaton strategjitë për shfrytëzimin e të dhënave mbi të arriturat e nxënësve të ndara sipas gjinisë;
- 1.7. Siguron që praktikat e vlerësimit të nxënësve në mbarë shkollën të jenë të drejta, të përshtatshme dhe të balancuara;
- 1.8. Siguron që pedagogjia e duhur është shfrytëzuar si përgjigje ndaj aspekteve të ndryshme të shumëllojshmërisë së nxënësve;
- 1.9. Shfrytëzon burime të ndryshme të informatave për vendimet të cilat ndikojnë në mirëqenien e nxënësve në shkollë;
- 1.10. Njeh mundësitë e teknologjisë së re dhe asaj në zhvillim, dhe bën të mundur integrimin e tyre të plotë në mbështetje të mësimdhënies dhe të nxënies.

Neni 9

ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE

9.1. Treguesit e performancës:

- 1.1. Menaxhmenti i shkollës, në planifikimin e ZhPM, përfshin nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit,
- 1.2. Praktikrat e zhvillimit profesional të mësimdhënësve janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve,
- 1.3. Praktikrat e zhvillimit profesional të mësimdhënësve janë në funksion ngritjes profesionale të mësimdhënësve,
- 1.4. Praktikrat e zhvillimit profesional të mësimdhënësve janë në funksion të mësimdhënies së integruar,
- 1.5. Shkolla shfrytëzon në mënyrë efikase resurset e saj për aktivitetet e ZhPM,
- 1.6. Shkolla mbikëqyrë ndikimin e ZhPM në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.

Neni 10

PERFORMANCA E NXËNËSVE

10.1. Treguesit e performancës:

- 1.1. Nxënësit ushtrojnë përgjegjësitë e veta sociale e qytetare në klasë, në shkollë dhe në komunitet,
- 1.2. Arritshmëria dhe progresi i nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore plotëson pritshmërinë e vendosur me KB (Kurrikulen Bertham),
- 1.3. Arritshmëria dhe progresi i nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushat kurrikulare plotëson pritshmërinë e vendosur me KB,
- 1.4. Nxënësit janë të angazhuar në aktivitete ekstra-kurrikular,
- 1.5. Nxënësit janë të angazhuar në menaxhimin e përparimit vetjak.

Neni 11

Në rast se për ndonjë shkollë ndonjë nga kategoritë e mësipërme nuk përkon, atëherë ajo nuk vlerësohet.

Neni 12

Notat e vlerësimit

12.1. Vlerësimi për realizimin e objektivave të punës përbën 50% të rezultatit final të vlerësimit për vendin e parë, ndërsa vlerësimi i vendit të dytë 30% kurse vendi i tretë me 20% të rezultatit final të vlerësimit.

12.2. Objektivat dhe aftësitë vlerësohen me nota nga 1 deri në 5.

12.3. Rezultati final i vlerësimit llogaritet sipas mesatares së fituar dhe pasqyrohet si vijon:

- 1.1. Nga 1 deri më pak se 1.5 nënkupton “dobët”;
- 1.2. Nga 1.5 deri më pak se 2.5 nënkupton “mjaftueshëm”;
- 1.3. Nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton “mirë”;
- 1.4. Nga 3.5 deri më pak se 4.5 nënkupton “shumë mirë”;
- 1.5. Nga 4.5 deri në 5 nënkupton “shkëlqyeshëm”.

12.4. Kuptimi i notave në paragrafin 2 të këtij neni është si në vijim:

1.1. “Shkëlqyeshëm”, vlerësohet shkolla, e cila jo vetëm i ka arritur të gjitha objektivat e punës (përmes realizimit të të gjitha aktiviteteve), por ka treguar edhe aftësi dhe cilësi të punës, që tejkalon shumë pritjet. Po ashtu ajo ka kontribuar thelbësisht në realizimin e objektivave të institucionit.

1.2. “Shumë mirë”, vlerësohet shkolla, e cila jo vetëm i ka arritur të gjitha objektivat e punës (përmes realizimit të të gjitha aktiviteteve), por kanë treguar aftësi dhe cilësi të punës, që tejkalon pritjet, ka kontribuar në realizimin e objektivave të institucionit.

1.3. “Mirë”, vlerësohen shkolla, e cila i ka arritur të gjitha objektivat e punës (përmes realizimit të të gjitha aktiviteteve) dhe kanë treguar aftësi dhe cilësi të pritshme.

1.4. “Mjaftueshëm”, vlerësohen shkollat, që i kanë arritur vetëm disa nga objektivat e punës (përmes realizimit të disa nga aktivitetet e parapara) dhe kanë treguar aftësi dhe cilësi nën pritjet. Kontributi i tyre nuk ka ndikuar, ose ka ndikuar vetëm pjesërisht në realizimin e objektivave të institucionit.

1.5. “Dobët”, vlerësohen shkollat, që nuk e kanë arritur shumicën e objektivave (pra, shumicën e aktiviteteve) dhe kanë treguar aftësi dhe cilësi nën pritjet. Kontributi i tyre ka ndikuar në mosarritjen e objektivave të njësisë organizative, gjegjësisht të institucionit.

12.5. Vetëm vlerësimi “dobët” konsiderohet si “vlerësim negativ”.

Neni 13

Kufizimet në nivelet e vlerësimit

13.1. Për çdo njërën nga tre kategoritë funksionale të institucioneve shkollore, vlerësimi nuk mund të kalojë limitet si më poshtë:

- 1.1. Jo më shumë se 50% vlerësuar “shkëlqyeshëm”;
- 1.2. Jo më shumë se 30% vlerësuar “shumë mirë”;
- 1.3. Jo më shumë se 20% vlerësuar “mirë”.

Neni 14

Procedura e vlerësimit të rezultateve në shkolla

Procedura e vlerësimit të rezultateve në shkolla zhvillohet me plotësimin e formularit të vlerësimit (formular i përgatitur nga Komisioni Vlerësues dhe DKA), me zhvillimin e intervistës së vlerësimit dhe me konfirmimin e rezultatit të vlerësimit.

Neni 15

Komisioni- Plotësimi i formularit të vlerësimit

15.1. Komisioni i Vlerësimit përbëhet nga pesë antarë, e themelon Asambleja Komunale, tre antarë nga asambleja, një zyra e kryetarit dhe një nga DKA-ja, duke respektuar strukturën gjinore.

15.2. Formulari i vlerësimit të rezultateve në shkolla plotësohet nga komisioni vlerësues, mbështetur në të dhënat e mbledhura prej tyre gjatë periudhës së vlerësuar lidhur me arritjen e objektivave në shkollën e vlerësuar.

15.3. Për çdo objektiv të shkollës të vlerësuar me notat 1, 4 dhe 5, komisioni vlerësues duhet të arsyetojë vendimin e tij, përmes plotësimit të pjesës së komenteve në formularin e vlerësimit.

15.4. Komisioni i Vlerësimit në bashkëpunim me DKA-në, ka mandatin të shtojë kriteret shtesë, sipas nevojë së kohës, në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës dhe të formuloj formularin për vlerësim.

Neni 16

Takim lidhur me vlerësimin e rezultateve në shkolla

16.1. Komisioni vlerësues e njofton DKA-në me kohë për datën, orën, vendin e takimit, dhe ia dorëzon formularët e vlerësimit, të plotësuar nga Komisioni vlerësues.

16.2. Gjatë takimit, njoftohen edhe shkollat e vlerësuara.

16.3. Vlerësuesi (Komisioni) mund të marrë në konsideratë argumentet e shkollës së vlerësuar dhe të jap rekomandime eventuale profesionale të cilat do të ndikojnë pozitivisht në ndryshimin dhe bërjen më mirë të punëve në shkollë.

16.4. Më këtë rast Komisioni nxjerr edhe rezultatet finale të vlerësimit dhe ato i dorëzon tek Drejtori i DKA-së, të cilat pastaj dërgohen tek **Kryetari i Komunës për tu miratuar**.

Rezultati publikohet në faqën zyrtare të komunës së Deçanit.

16.5. Kryetari i komunës, në emër të institucionit që përfaqëson, duke iu referuar vlerësimit të cilin e ka marr nga Komisioni për vlerësimin e shkollës më të mirë për vitin aktual, ndanë **edhe tri çmimet e para për Shkollën më të mirë në Komunën e Deçanit me çmimin “Njazi Ferizi”**. Vendit të parë fitues i ndahen 5.000 euro, Vendit të dytë fitues i ndahen 3.000 euro dhe vendit të tretë fitues i ndahen 2.000 euro. Çmimet ndahen në formë grandi, ku shkollat fituese i bëjnë kërkesat (Projektet) sipas nevojës që kanë, dhe zyra prokurimit e hapë tenderin. Pra, çmimi i fituar (të hollat) shpenzohen me tender-kërkesë nga shkollat (3 vendet e para).

Projektet (Kërkesat) e shkollave fituese, vlerësohen nga Komisioni Vlerësues, i cili ka udhëhequr me vlerësimin.

16.6. Formulari i vlerësimit i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje (Formulari sipas fushave).

Neni 17
Roli i institucionit - shkolla që vlerësohet

17.1. Institucioni (shkolla) i ofron ndihmë teknike Komisionit të vlerësimit për vlerësimin e rezultateve të punës së shkollës.

17.2. Komisioni për vlerësim (Kryetari i komisionit), e njofton udhëheqësin e institucionit me formularin e vlerësimit dhe arsyet e vlerësimit.

17.3. Pas zhvillimit të procedurës së vlerësimit, Komisioni për vlerësim e harton raportin përmbledhës për rezultatet e vlerësimit të institucionit përmes Drejtorit të DKA-së ia kalon Kryetarit të Komunës më së largu 23 ditë pune nga dita e udhëheqësit më të lartë administrativ të institucionit përkatës më së largu deri më 7 janar të vitit kalendarik pasues.

Neni 18
Raporti përmbledhës i vlerësimit

18.1. **Në pajtim Ligjin**, Shkollat që vlerësohen, dorëzojnë raportet përmbledhëse për vlerësimin tek Komisioni sipas kërkesës dhe udhëzimeve nga ky Komision.

18.2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, raporti përmbledhës përmban numrin e shkollave të vlerësuar në secilën nga notat e vlerësimit, nga pesë (5) deri në një (1), si dhe rezultatin e përgjithshëm të vlerësimit bazë.

Neni 19

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 20

Përgjegjëse për zbatimin e kësaj Rregulloreje është: Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërkaq mbështetës për zbatimin e saj do të jenë Asambleja Komunale në Deçan dhe Kryetari i Komunës.

Neni 21

Në rast të mosmarrëveshjeve, interpretimin autentik të kësaj Rregulloreje e bën Drejtoria Komunale e Arsimit me vendim të veçantë.

Neni 22

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregulloret-Vendimet që bien ndesh me këtë rregullore.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në faqen elektronike të Kuvendit Komunal të Deçanit.

01.Nr.XIII-2

Deçan, dt.29.10.2021

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Z. Haki SHEHAJ

REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT OPSTINA DEÇAN	
№ i regjistruar R.K. Deçan	№ i regjistruar 38237
№ i dërguar 01	№ i dërguar 08.11.21